



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 238, Datë 06.11.2024

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ORHER” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, 38, pika 1, gërma “a”, dhe 39, pika 4, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1958/10 prot., datë 04.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “ORHER” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “ORHER” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1958 prot., datë 23.09.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW, në Zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 210, datë 07.10.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ORHER” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 08.10.2024 dhe 09.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 17.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 2105 prot., datë 11.10.2024, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën me nr. 1958/3 prot., datë 11.10.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i evidentuar

- informacionin/dokumentacionin e munguar për këtë aplikim. ERE, me qëllim sqarimin e këtij informacioni/dokumentacioni, me e-mailin e datës 15.10.2024, protokolluar me nr. 1958/5 prot., njoftoi shoqërinë për zhvillimin e një seance dëgjimore.
- Pas sqarimeve të dhëna në seancën e zhvilluar në datën 21.10.2024, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1958/6 prot., datë 28.10.2024 dhe nr. 1958/9 prot., datë 01.11.2024, shoqëria ka plotësuar informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “ORHER” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me MIE-n Kontratën nr. 2996 Rep., nr. 1957 kol., datë 24.05.2023 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “ORHER” sh.p.k.”;
 - Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes, dokumentuar në ERE nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a. nr. 2740/3 prot., datë 20.03.2023;
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më 11.04.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “*Impianti Fotovoltaike Orher, 2 MW*”. Rezulton se shoqëria disponon aktualisht një VNM të vlefshme dhe, për sa i përket fillimit të punimeve, ajo ka bërë me dije se është në proces për t’u pajisur me lejen e nevojshme. Në të tilla rrethana, vlerësohet që t’i lihet kusht asaj që të dokumentojë fillimin e tyre jo më vonë se data 11.04.2025, (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e lejes aktuale). Në rast se shoqëria nuk dokumenton fillimin e punimeve brenda kësaj date, ajo duhet të depozitohet në ERE një VNM të re.
- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit, sikurse deklaruar nga shoqëria dhe sikurse konstatohet në planin e biznesit, centrali fotovoltaike ka një jetëgjatësi 30-35 vjet, duke përfshirë mundësinë e zëvendësimit të njësive gjeneruese në vitin e 26, ndaj vlerësohet që dhe licenca të jepet për jetëgjatësinë e plotë të centralit, pra për 25 vjet.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të Kontratës me 2996 Rep., nr. 1957 kol., datë 24.05.2023, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të fillojë punimet brenda 90 ditëve nga pajisja me të gjitha lejet (me të cilat nuk është pajisur akoma) dhe se do të vendosë në punë

centralin brenda 12 muajve nga pajisja me këto leje. Në këto rrethana vlerësohet të përcaktohet që shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të kontratës së nënshkruar me Autoritetin Kontraktor.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ORHER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 25-vjecar.
2. Shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaiik brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake (brenda datës 11.04.2025), ose duhet të depozitojë në ERE një VNM Paraprake të re.
3. Shoqëria të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të përcaktuara në kontratën e nënshkruar me MIE-n.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kuadër të pikës 2 dhe 3.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “ORHER” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI